



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2022

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data 27/06/2022

Drejtuar: Bashkimit te Operatoreve Ekonomik “RAFAELO 2002” SH.A & “ULZA” SH.P.K & “ADVANCED” SH.P.K, perfaqesuar nga Operatori Ekonomik “RAFAELO 2002” SH.A, me adrese Njësia Bashkiake nr. 11, Rruga “29 Nentori”, kthesa e Kamzës, zonë kadastrale nr. 8310, numër pasurie 12/104, Tirane.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur /Pune.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-31669-06-03-2022.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikonstruksioni i Çerdhes se qytetit Lezhe”.

Kohëzgjatja e kontratës: 4 muaj nga nenshkrimi i kontrates.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “Eduart Çela” P/F, me Nuis M03806202I, pa oferte ekonomike,
2. Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “RAFAELO 2002” SH.A, me Nuis K22113003Q & “ULZA” SH.P.K, me Nuis J67902928O & “ADVANCED” SH.P.K, me Nuis K81413042D dhe me oferte ekonomike 24,880,305.75 (njetzet e kater milion e teteqind e tetedhete mije e treqind e pese **pike** shtatedhete e pese) Lek pa TVSH,
3. Operatori Ekonomik “T&XH” SH.P.K, me Nuis L72121504I dhe me oferte ekonomike 21,496,547.5 (njetzet e nje milion e katerqind e nentedhete e gjashte mije e peseqind e dyzet e shtate **pike** pese) Lek pa TVSH.

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

I- Operatori Ekonomik “EDUART ÇELA” P/F, me Nuis M03806202I

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE nuk permbush asnje nga kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshetur nenin 76, pika 3/a dhe ne nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, te ligjit nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatorët ekonomikë bazuar në: a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftesine teknike dhe profesionale. Kerkesat kufizohen vetem ne ato qe jane te pershtatshme per te garantuar qe nje kandidat ose ofertues te ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftesite teknike e profesionale per te zbatuar kontraten qe do te jepet. Te gjitha kerkesat duhet te kenë lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates. 4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatorët ekonomikë zoterojne burimet e nevojshme njerzore e teknike, si dhe pervojën e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatorët ekonomikë te kenë nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara ne te shkuaren. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë per te ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojën e duhur, si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten, siç është pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates. 5. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne ne njoftimin e kontrates ose ne ftesën per shprehje interesi kriteret e perzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatorët ekonomikë per permbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne bazuar ne nenin 92, pika 3 te ligjit nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", ku parashikohet: "Autoriteti ose enti kontraktor, ne zbatim te pikës 4 te ketij neni, vlereson nje ofertë te vlefshme vetem nese ajo është ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me percaktimet e nenit 38 te ketij ligji", vendosi te refuzoje oferten e Operatorit Ekonomik "EDUART ÇELA" P/F, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, ne mbeshetje te nenit 92, te ligjit nr. 162/2020 "Per prokurimin publik", Operatori Ekonomik "EDUART ÇELA" P/F, me Nuis M03806202I, skualifikohet.

II- Operatori Ekonomik "T&XH" SH.P.K, me Nuis L72121504I,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson kriterin 1, ne lidhje me Kriteret e pergjithshme te perzgjedhjes/ kualifikimit dhe piken 2.1.1, te kushteve te vecanta te kualifikimit ne te cilin percaktohet se ky kriter plotesohet: **2.1.1** Sipas kriterëve te pergjithshme dhe te vecanta te kualifikimit (Shtojcat)".

KVO, veren se ne shtojcen 7, parashikohet si me poshte:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT
Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;**
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Gjithashtu KVO, verën se bazuar në pikën 1 dhe 2(c), të nenit 26, të VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla,

2. formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

...dhe per te permbushur këto kritere duhet të paraqitet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit të operatoreve ekonomike në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori Ekonomike nuk ka plotësuar te dhenat per personin/at në cilësinë e anëtarit të *organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit si me poshte:

ne kreun A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, ne seksionin ne lidhje me informacionin dhe deklarimin ne zbatim te pikes 2(c) te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, ne te cilin duhet te deklarohet si me poshte:

“ç) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së”;

KVO referuar vendimit te KPP nr. 537/2019, date 14.08.2019, ne te cilin ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues ne kete vendim pikerisht sepse nuk ka plotësuar e deklaruar te gjithë emrat sipas formatit te shtojces 8 te DST. Konkretisht, KPP ne kete vendim shprehet:...

“KPP gjykon se në rastin konkret nuk jemi ne kushtet e devijimit të vogël apo pamundësisë së autoritetit kontraktor për të verifikuar se kush është ortaku i shoqërisë Marketing&Distribution shpk, por jemi përballë mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese”. Format i shtojcës e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë subjekteve të përmëndur më sipër në mënyrë nominale ndryshe shtojca do të ishte konceptuar në mënyrë të përgjithshme. Për këtë shkak shtojca e dorëzuar nga anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë II Marketing&Distribution shpk nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar”.

Sa me lart duke qene se formati i shtojcës 8, e kërkon që të citohen emrat konkretë të të gjithë personave në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendim marrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik në mënyrë nominale ndryshe shtojca do të ishte konceptuar në mënyrë të përgjithshme. Për këtë shkak shtojca nr. 8, e dorëzuar nga OE nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar, duke mos permbushur kete kriter.

Se dyti, nuk ka paraqitur shtojcen nr. 2, te parashikuar ne DST, sipas formatit te meposhtem:

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*
LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

<i>Nr</i>	<i>Nr. Analizë</i>	<i>Përshkrimi i Punëve</i>	<i>Njësi</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi/ Njësi</i>	<i>Cmimi total</i>
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

KVO mban ne konsiderate se ne nenin 14, te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, parashikohet se: “APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate”.

Po ashtu KVO mban ne konsiderate se formati i shtojces nr. 2, per procedurat e prokurimit “E hapur e thjeshtuar/ Mallra” eshte miratuar me vendimin nr. 03, date 09.06.2021 “Per miratimin e dokumentave standarte te tenderit per mallra, pune , sherbime per proceduren e prokurimit “Procedure e Hapur e thjeshtuar”, e korigjuar me ane shkreses 2416/6 date 14.06.2021 dhe asnje autoritet kontraktor apo operator ekonomik nuk mund te modifikoje apo te ndryshoje formularet e miratuar ne DST.

Per me teper, KVO konstaton se ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i Çerdhes se qytetit Lezhe”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken A/2 b) percaktohet se: **“b) Operatori Ekonomik duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti/ Enti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, do të cojë në refuzimin e Ofertës”.**

Ndersa ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i Çerdhes se qytetit Lezhe”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/4, percaktohet se: *Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar.*

Po ashtu ne dokumentat standarte te tenderit te procedures se prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i Çerdhes se qytetit Lezhe”, ne seksionin I, udhezime per Operatoret Ekonomike, ne piken B/10 **“Formati dhe nenshkrimi i ofertes”**, percaktohet se: **Në përgjigje të Njoftimit të Kontratës, cdo Operator Ekonomik paraqet ofertën sipas formularëve standard në këtë DT. Oferta nënshkruhet nga personi/personat përgjegjës të autorizuar për këtë qëllim.**

Nga verifikimi ne SPE, verehet se OE ka paraqitur nje preventiv oferte i cili nuk permban asnje nga elementet apo deklarimet e parashikuara ne Shtojcen nr. 2, te DST-se.

Nisur sa me lart, KVO thekson se ne kete rast jemi përmballë mosparaqitjes dhe mosplotësimit në formën e duhur të një shtojce e cila është pjesë përbërëse e dokumentave të procedurës së prokurimit dhe është e detyrueshme që të plotësohet sipas formatit të miratuar nga organet ligjzbatuese, pasi mosdhënia nga operatori ekonomik e të gjithë informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në Dokumentet e Tenderit, do të cojë në refuzimin e Ofertës”.

Se treti, nuk ploteson kriterin 2.3.5 te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: **“2.3.5 Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:**

- | | | |
|---------------------|---------|--|
| - Teknik Ndertimi | 1 (nje) | Diplome shkolles mesme |
| - Teknik Mekanik | 1 (nje) | Diplome shkolles mesme |
| - Teknik Hidraulik | 1 (nje) | Diplome shkolles mesme |
| - Teknik Elektronik | 1 (nje) | Diplome shkolles mesme |
| - Teknik Elektrik | 1 (nje) | Diplome shkolles mesme |
| - Karpertier | 1 (nje) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale |
-

- | | | |
|---------------|---------|--|
| - Suvatues | 1 (nje) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale |
| - Plakashtues | 1 (nje) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale |
| - Bojaxhi | 1 (nje) | Çertifikate trajnimi/Deshmi Profesionale |

Operatori ekonomik duhet te paraqese per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome e shkolles mesme/ Çertifikate trajnimi/ Deshmitë profesionale, sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Shkurt 2022 - Prill 2022.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit”.

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit e mbeshtetes qe disponon sipas percaktimeve te mesiperme.*

KVO thekson se referuar bazes ligjore te sipercituar, per vleresimin e ketij kriteri ne kete faze te procedures, duhet ti referohet vetem formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pasi bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021, nuk legjitimohet per te kryer verifikimin dokumentacioni nese eshte paraqitur ndonje dokument shtese i sakte apo i pasakte duke qenes se ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, disponimin e asnje nga punonjesit te stafit mbeshtetes te sipercituar duke mos permbushur kete kriter.

Se katerti, nuk ploteson kriterin 2.3.6, *ku parashikohet se: Operatorët Ekonomike duhet te kene ne stafin teknik ose mbeshtetes, te certifikuar te pakten:*

2.3.6/a -1 (nje) punonjes te pajisur me çertifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listepagesat e shoqerise të paktën për periudhën Shkurt 2022 - Prill 2022.

2.3.6/b -1 (nje) punonjes te paisur me certifikate “Per punime ne lartesi”. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune dhe certifikaten perkatese ose deshmi nga institucione te akredituara si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Shkurt 2022 - Prill 2022.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit”.

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit e mbeshtetes qe disponon sipas percaktimeve te mesiperme.*

KVO thekson se referuar bazes ligjore te sipercituar, per vleresimin e ketij kriteri ne kete faze te procedures, duhet ti referohet vetem formularit përmbledhës të vetedeklarimit, pasi bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021, nuk legjitimohet per te kryer verifikimin dokumentacioni nese eshte paraqitur ndonje dokument shtese i sakte apo i pasakte duke qenes se ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, disponimin e punonjesve te certifikuar ne stafin teknik ose mbeshtetes te sipercituar sipas kriterit 2.3.6 te DST-se, duke mos permbushur kete kriter.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 76, pika 3/a dhe ne nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e

objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “T&XH” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Operatori Ekonomik “T&XH” SH.P.K, me Nuis L72121504I, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomik “RAFAELO 2002” SH.A & “ULZA” SH.P.K & “ADVANCED” SH.P.K, përfaqesuar nga Operatori Ekonomik “RAFAELO 2002” SH.A dhe me adresë Njësia Bashkiake nr. 11, Rruga “29 Nentori”, kthesa e Kamzës, zonë kadastrale nr. 8310, numër pasurie 12/104, Tirane, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 24,880,305.75 (njezet e kater milion e teteqind e tetedhete mije e treqind e pese **pikë** shtatedhete e pese) Lek pa TVSH është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU